

**VENDIMI I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME**  
**I SHOQËRISË “PLANITALBA” SH.P.K**

Sot, në Tiranë, më datë 18.06.2021 në orën 17:00 pranë selisë së shoqërisë “Planitalba” sh.p.k., me adresë në Rruga Shyqyri Bërxolli, Apartamenti 3/4 - seksioni B, Tiranë, e regjistruar në regjistrin tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me numër unik identifikimi (NUIS) L91924027J, u mbledh rregullisht Asambleja e Përgjithshme të Shoqërisë.

Rezulton se, janë të pranishëm në mbledhje të gjithë ortakët me anë të video konferencës (*Microsoft Teams Meeting*), të identifikuar me anë të pasaportës/letërnjoftimit ID për individë dhe ekstraktit tregtar për personat juridikë, sa vijon:

- Ortaku **Z. Umesh Kumar Sahdev**, shtetas indian, identifikuar me pasaportë nr. Z5531405 lëshuar më datë 14.06.2019 e vlefshme deri më date 13.06.2029, i cili posedon 10% të kuotave të shoqërisë;
- Ortaku **Zj. Brikena Juba**, shtetase shqiptare, identifikuar me kartë identiteti me nr. personal H95120065E lëshuar më date 27.04.2021 e vlefshme deri më datë 26.04.2031, që posedon 10% të kuotave të shoqërisë;
- Shoqëria **Planit Travglobal Private Limited**, shoqëri e huaj e përfaqësuar nga Z. Linus James Paul, i identifikuar me pasaportë nr. L8540456 lëshuar më date 15.04.2014 e vlefshme deri më datë 14.04.2024, ortaku që posedon 40% të kuotave të shoqërisë;
- Shoqëria **Albatrip shp.k.**, shoqëri shqiptare e cila perfaqesohet me vendimin e saj datë 17.06.2021 nga Z. Elizaveta Atakova, i identifikuar me kartë identiteti me nr. 5525017 lëshuar më datë më 23.07.2013 e vlefshme deri më datë 23.07.2023, ortaku që posedon 40% të kuotave të shoqërisë;

Gjithashtu, është prezent administratorja e vetme e kësaj shoqërie, Zj. Denisa Dalla. Me dakordësi unanime të të gjithë të pranishmëve, e merr presidencën Elizaveta Atakova, e cila emëron si Sekretare/Përkthyes Xhesilda Balashi, dhe kjo e fundit e pranon këtë detyrë. Presidenti verifikoi dhe konfirmoi se, janë mbledhur të gjithë ortakët, që së bashku formojnë kuorumin e plotë në 100% të kuotave pjesëmarrëse në shoqërinë “Planitalba” Sh.p.k., sipas përcaktimit ligjor dhe atij statutor i mjaftueshëm, prandaj është në gjendje të marrë vendime.

Në këtë mbledhje u diskutua lidhur me rendin e ditës si më poshtë:

1. Prishja dhe Vendosja në likuidim të thjeshtëzuar të shoqërisë “Planitalba” shp.k;
2. Regjistrimin e këtij vendimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB);

3. Të ndryshme.

Në kuadër të zbatimit të nenit 204 i Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar në lidhje me kushtet dhe procedurën e likuidimit të thjeshtëzuar, lind nevoja e marrjes së një vendimi në unanimitet të plotë nga Asambleja e Ortakëve që të bëjë të mundur prishjen e shoqërisë dhe vendosjen e saj në likuidim.

Presidenti i kërkon të pranishmëve për të proceduar me votimet përkatëse për prishjen dhe vendosjen në likuidim të thjeshtëzuar shoqërinë “Planitalba” shp.k. Më pas kalohet në trajtimin e pikave të tjera si rezultat i votimit të pikës së parë sa më sipër. Mbledhja u konsiderua e rregullt pasi në përputhje me parashikimet e Statutit të Shoqërisë “Planitalba” Sh.p.k dhe Ligjit Nr. 9901 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, janë të pranishëm personalisht të gjithë ortakët që zotërojnë 100 % të aksioneve në kapitalin e Shoqërisë.

Për sa më sipër, Asambleja e Aksionerëve të shoqërisë “Planitalba” sh.p.k, pasi shqyrtuan çështjet e rendit të ditës në unanimitet të plotë;

**VENDOSËN**

1. Prishjen dhe Vendosjen në likuidim të thjeshtëzuar të shoqërisë “Planitalba” shp.k;
2. Regjistrimin e këtij vendimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB);
3. të autorizojnë Administratorin e Shoqërisë ose persona të autorizuar prej këtij të fundit, të ndjekin të gjitha procedurat ligjore dhe të kryejnë veçmas, regjistrimin e këtij vendimi së bashku me të gjitha aktet e tjera shoqëruese pranë regjistrimit tregtar, Tiranë.

Duke mos patur asnjë pikë tjetër për të diskutuar, Presidenti e deklaroi mbledhjen e mbyllur në orën 18:00 pas shkrimit, leximit dhe aprovimit të këtij Vendimi.

**PËR SHOQËRINË “PLANITALBA” SH.P.K.**

**Presidenti**

*Elizaveta Atanova*

*[Signature]*

**Sekretari/Përkthyesi**

*Khesilda Balashi*

*[Signature]*



**VENDIM I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME I ORTAKËVE TË  
SHOQËRISË ALBATRIP SH.P.K.**

Sot, më datë 17.06.2021 (dymijënjëzetënjë), në Tiranë, në Rruga "Shyqyri Berxolli", Apartamenti 3/4, Seksioni B, Kati +3, u mbledh Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë ALBATRIP Sh.p.k., (në vijim "Shoqëria"), shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe e organizuar sipas ligjeve shqiptare, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më datë 06.05.2011 me numër unik identifikimi (NUIS) L11706010D, me seli ne adresën e mësipërme. Kapitali i shoqërisë Lekë 15.290.000,00 është i nënshkruar dhe i paguar tërësisht dhe zotërohet në masën 100% nga Ortakët: Z. Ylli Sula (51%), Zj. Ilta Bylykbashi (49%).

Në Asamblenë e Përgjithshme marrin pjesë personalisht Ortakët e shoqërisë në cilësinë e organit vendimmarrës të saj:

- Z. Ylli Sula, shtetas shqiptar, lindur me 01.08.1966, në Tiranë, banues në Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit me nr. personal G608011620;
- Zj. Ilta Bylykbashi, shtetase shqiptare, lindur me 19.06.1979 në Tiranë, banuese në Tiranë, mbajtëse e kartës së identitetit me nr. personal H95619051V;

Asambleja e Përgjithshme është thirrur rregullisht dhe sipas afatit nga Administratori i saj për të diskutuar dhe votuar për rendin e ditës në vijim:

1. Autorizimin e personit pjesëmarrës në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë PLANITALBA sh.p.k, në të cilën shoqëria Albatrip sh.p.k mban pozicionin e Ortakut, mbledhje e cila do të realizohet nëpërmjet video konferencës (*Microsoft Teams*) më datë 18.06.2021 ora 17:00, me rend dite si më poshtë vijon:

- Prishja dhe vendosja në likuidim të thjeshtëzuar të shoqërisë "Planitalba" sh.p.k;
- Regjistrimin e vendimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB);



- *Të ndryshme.*

Pas diskutimesh midis ortakëve të ALBATRIP Sh.p.k., duke konstatuar përmbushjen e kuorunit të kërkuara nga ligji dhe Statuti për të votuar, Asambleja e Përgjithshme

#### VENDOSI:

2. Të autorizojë **Znj. Elizaveta Atakova**, shtetase Ruse, lindur më 06.08.1991 në Shen Peterburg te Rusise, dhe banuese ne Tirane, identifikuar nëpërmjet mjetit të identifikimit te llojit Pasaporte te Federates Ruse me nr. personal 725525017 lëshuar më 23.07.2013 dhe e vlefshme deri më 23.07.2023, e punesuar prane shoqerise Albatrip, për të marrë pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë PLANITALBA sh.p.k, mbledhje e cila do të realizohet nëpërmjet video-konferencës (Microsoft Teams), më datë 18.06.2021, ora 17:00 me rend dite si më lart parashikuar.

Pas nuk kishte asgjë tjetër për të diskutuar mbledhja u konsiderua e mbyllur dhe ky vendim u nënshkrua rregullisht nga ortakët e shoqërisë ALBATRIP Sh.p.k.

#### ORTAKËT E SHOQËRISË ALBATRIP SH.P.K.

Z. Ylli SULA

Zj. Ilta BYLYKBASHI

